BASHKIA
SHKODËR

# P13. Emergjencat Civile

## "Përmirësim i masave organizative dhe burimeve për mbrojtjen civile dhe menaxhimin e katastrofave”

Përmbajtja


P13. Emergjencat Civile 3
1. Hyrje 3
2. Politikat e zhvillimit 3
3. Funksionet: 4
3.1. F1. Planifikim, menaxhim, përballim i emergjencave civile. 4
3.1.1. Aktivitetet dhe projektet që planifikohen në përmbushje të objektivit F1.O1 4
3.2. F2. Mbrojtja nga Zjarri dhe Shpëtimi.(MZSH). 4
3.2.1. Aktivitetet dhe projektet që planifikohen në përmbushje të objektivit F2.O1 5
3.2.2. Aktivitetet dhe projektet që planifikohen në përmbushje të objektivit F2.O2 5
4. Buxhetimi i programit të Emergjencave Civile 6
5. Projektet dhe aktivitetet e planifikuara për emergjencat civile 7

## P13. Emergjencat Civile

### 1. Hyrje

Planizimi dhe përballimi i emergjencave civile janë detyra të shtetit shqiptar që synon:

- a) parandalimin, pakësimin dhe riaftësimin nga çdo dëmtim që prek popullatën, gjënë e gjallë, pronën, trashëgiminë kulturore dhe mjedisin nga emergjencat civile;
- b) sigurimin e kushteve për institucionet shtetërore, publike e private, për veprimtaritë ekonomike dhe për popullatën, për kalimin nga gjendja normale e jetesës dhe e punës në një situatë emergjente, me humbje sa më të vogla për ruajtjen e rendit, për jetën e njerëzve, për gjënë e gjallë, për pronën, për trashëgiminë kulturore dhe për mjedisin kundër efekteve të një emergjence civile;
- c) garantimin e përdorimit të të gjitha burimeve të mundshme të shtetit, me qëllim sigurimin publik, ruajtjen e vazhdueshme të ekonomisë kombëtare, lokalizimin e zonës së emergjencës dhe lehtësimin e pasojave.

Bashkitë dhe komunat kanë përgjegjësi për parapërgatitjen, planifikimin dhe operacionet e përgjigjes ndaj situatave emergjente që ndodhin në territorin e tyre. Menaxhimi i emergjencave civile në bashki bëhet në përputhje me planet e emergjencave ose planet e gatishmërisë që përgatiten periodikisht.

Në nivel vendor krijohet sistem i:

- Njoftimit të hershëm dhe informimit të strukturave kyç.
- Alarmit dhe evakuimit të popullsisë.
- Skuadrave, grupeve dhe strukturave të tjera aktive të përgatitura për të parandaluar, për të lehtësuar dhe për t'u përgjigjur në raste të emergjencave civile.
- Bashitë Ndërmarrin dhe administrojnë aktivitetet e rehabilitimit për zonën e prekur nga emergjenca

### 2. Politikat e zhvillimit

Zvogëlimi i riskut nga fatkeqësitë dhe menaxhimi i tyre, duke siguruar mbrojtjen e jetës së njerëzve, pronës, trashëgimisë kulturore dhe mjedisit, nëpërmjet sistemit të mbrojtjes civile.

Perafrimi me standartet europiane të organizimit të mbrojtjes civile

Sigurimi i mbrojtjes civile në të gjithë territorin

Parandalimi nga dwmtime tw emergjencave civile

Informim publik per reziqet dhe aktivitetet e organeve vendore përgjegjëse për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera

## 3. Funksionet:

### 3.1. F1. Planifikim, menaxhim, përballim i emergjencave civile.

**F1.O1.Krijimi i strukturave per planifikimin, menaxhimin dhe përballimin e emergjencave civile.**
**Situata e vleresuar në fund te vitit 2016:**

- Ka një drejtori përgjegjëse për emergjencat civile që menaxhon dhë shërbimin e MZSH. Në zbatim të ligjit është vlerësuar nevoja e riorganizimit në dy drejtori të veçanta, në atë të Emergjencave Civile dhe në atë të Mbrojtjes nga Zjarri dhe shpëtimi, për të krijuar mundësinë e funksionimit më të mirë të shërbimeve për mbrojtjen civile.

| Situata e synuar 2017 | Situata e synuar 2018 | Situata e synuar 2019 |
|---|---|---|
| **Shërbime më të mira të Drejtorisë së Emërgjave Civile si rezultat i rritjes së stafit dhe organizimit më të mirë të ndarjes së funksioneve.**<br>**Mbledhja e informacioneve për territorin dhe fillimi i vleresimit te riskut ne territor.**<br>**Rritja e kapaciteteve teknike dhe menaxheriale të stafit përmes trajnimeve.** | Shërbim i qëndrueshëm për mbrotjen civile në cdo pjesë të territorit.<br>Hedhja e të dhënave në database të burimeve dhe mjeteve.<br>Vlersim i përfunduar i riskut në tërritorin e Bashkisë.<br>Ngritja e strukturës së vullnetarëve civilë.<br>Rritja e kapaciteteve teknike dhe menaxheriale të stafit përmes trajnimeve. | Shërbim i qëndrueshëm për mbrotjen civile në cdo pjesë të territorit.<br>Zgjerimi i strukturës me vullnetarëve civilë.<br>Rritja e kapaciteteve teknike dhe menaxheriale të stafit dhe vullnetarëve përmes trajnimeve. |

#### 3.1.1. Aktivitetet dhe projektet që planifikohen në përmbushje të objektivit F1.O1

| Aktiviteti | Buxheti në mijë lekë |
|---|---|
| **P13.F1.O2.A1.** Organizimi i struktures së mbrojtjes civile dhe i strukturave vullnetare në Bashkinë Shkodër. | **1,500** |

### 3.2. F2. Mbrojtja nga Zjarri dhe Shpëtimi.(MZSH).

**F2.O1. Shërbim i përmirësuar i MZSH me prioritet parandalimin e ngjarjeve.**
**Situata e vleresuar në fund te vitit 2016:**

- Është rritur numri dhe llojet e shërbimeve të sektorit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi.
- Eshtë realizuar transferimi i funksionit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi tek Bashkia Shkodër sipas ligjit.
- Fondet e alokuara nga transferta specifike janë më pak se ato që alokoheshin për këtë sector në nivel prefecture. Këto fonde nuk përmbushin nevojën bazë për ofrimin e shërbimit minimalisht në standartin me të cilin është ofruar kur menaxhohej në nivel Prefekture.
- Struktura e ofrimit të shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi në numër është akoma larg standartit  kërkuar me ligj.

| Situata e synuar 2017 | Situata e synuar 2018 | Situata e synuar 2019 |
|---|---|---|
| **Shërbim më i mirë dhe më eficient i Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi, kapaciteve njerzore të përmirësuara.** | Shërbim më i mirë dhe më eficient i Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi, kapaciteve njerzore të përmirësuara. | Shërbim më i mirë dhe më eficient i Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi, kapaciteve njerzore të përmirësuara. |

### 3.2.1. Aktivitetet dhe projektet që planifikohen në përmbushje të objektivit F2.O1

| Aktiviteti | Buxheti në mijë lekë |
|---|---|
| **P13.F2.O1.A1. Ofrimi i shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi** | **35,574** |

**F2.O2 Plotësimi i kushteve të sigurise për mbrojtjen kundër zjarrit për të gjithë objektet në pronësi të Bashkisë Shkodër.**

**Situata e vleresuar në fund te vitit 2016:**

- Janë vendosur pajisjet e fikseve automatike të zjarrit në të gjitha objektet arsimore, godinat e Njësive Administrative të Bashkisë Shkodër.
- Janë vendosur kutiat e ndihmës së parë në të gjitha shkollat e Bashkisë Shkodër.

| Situata e synuar 2017 | Situata e synuar 2018 | Situata e synuar 2019 |
|---|---|---|
| **Plotësimi i dokumentacionit ligjor teknik për Mbrojtjen nga Zjarri dhe Shpëtimi dhe certefikimi për mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi për godinën e Bashkisë (veçanërisht).**<br>**Plotësimi i dokumentacionit ligjor teknik për masat Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi dhe certefikimi për Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi i të gjitha objekteve të vartësi të Bashkisë.**<br>**Rimbushja e bombulave të fikseve automatike të zjarrit.** | Kryerja e kontrollit sistematik vjetor dhe çertifikimi për Mbrojtjen nga Zjarri dhe Shpëtimi i ndërtesave të Bashkisë.<br>Blerja e fikseve automatike për objekte te tjera.<br>Rimbushja e bombulave të fikseve automatike të zjarrit | Kryerja e kontrollit sistematik vjetor dhe çertifikimi për mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi i objekteve të Bashkisë.<br>Blerja e fikseve automatike për objektet te tjera.<br>Rimbushja e bombulave të fikseve automatike të zjarrit |

### 3.2.2. Aktivitetet dhe projektet që planifikohen në përmbushje të objektivit F2.O2

| Aktiviteti | Buxheti në mijë lekë |
|---|---|
| **P13.F2.O2.A2.** Plotësimi i dokumentacionit ligjor teknik për masat Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi dhe çertifikimi për Mbrojtjen nga Zjarri dhe Shpëtimi i të gjitha objekteve të vartësi të Bashkisë. | **7,000** |

## 4. Buxhetimi i programit të Emergjencave Civile

Për realizimin e aktiviteteve/projekteve të Programit të Emergjencave Civile planifikohet buxheti me vlerë totale 40,473 mijë lekë ndër të cilat, 70 % paga dhe sigurime shoqërore, 19 % shpenzime operative, 7% investime, 4 % transferta.

**Tabelë 1 Planifikimi për Emergjencave Civile**

| Programi P10 | Paga + Sigurime | Shpenzime Operative | Subvensioni | Transferta | Investime | Totali |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Plani 2016** | | | | | | **0** |
| **Plani i ndryshuar 2016** | 28,891 | 10,442 | | 277 | | **39,610** |
| **I pritshmi 2016-12-mujor** | 27,629 | 8,691 | | 277 | | **36,597** |
| **Plani 2017** | 30,684 | 6,600 | - | 1,860 | 3,000 | **44,074** |
| **Plani 2018** | 31,297 | 6,600 | - | 1,860 | - | **39,757** |
| **Plani 2019** | 31,923 | 6,600 | - | 1.950 | - | **40,473** |




Grafik 1 Planifikimi i shpenzimeve për Emergjencave Civile




Grafik 2 Burimet e financimit për financimin e programit për emergjencat civile

## 5. Projektet dhe aktivitetet e planifikuara për emergjencat civile

| Nr. 1 | **Projekti: P13.F1.O1.A1**<br><br>Organizimi i strukturës së mbrojtjes civile dhe i strukturave vullnetare në Bashkinë Shkodër. | **Llojet e programit: P13** Planifikim, Manaxhim, Administrim<br><br>**Funksioni: P13.F1** Mbrojtja civile dhe administrimi i strukturave përkatëse, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj |
|---|---|---|

**a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:**

**i. Situata**

Baza ligjore: 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", Neni 29, LIGJ Nr. 152/2015 "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin", VKM nr 965 date 02.12.2015 "Për bashkëpunimin ndërinstitucional të strukturavë të drejtimit në rastet e Emergjencave Civile dhe krizave"
Bashkia Shkodër ka pësuar një seri ngjarjesh e fatkeqësish natyrore të cilat janë përballuar me angazhimin e shumë aktorëve lokalë dhe kombëtar. Deri me sot nuk ka ekzistuar një skemë funksionale e emergjencave civile për përballimin e situatave të mundshme të fatkeqësive natyrore që mund të godasin territorin e Bashkisë Shkodër prandaj është parë e nevojshme hartimi i një skeme funksionale të burimeve njerëzore dhe logjistikës së nevojshme për përballimin e situatave të fatkeqësive natyrore që mund të godasin territorin e Bashkisë. Volumi i punës që do mbulojë kjo strukturë parashikon mbulimin e kryerjes së këtyre detyrave si më poshtë:

- Përmirësimi i performancës në drejtim të veprimtarisë së emergjencave civile përmes hartimit të një skeme funksionale,
- Rritja e aftësive të personelit për të përballuar një gamë më të gjërë shërbimesh por dhe rritjen e eficiencës së zjarrfikësit por të sigurisë së tij personale.
- Pajisja me plane evakuimi te te gjitha institucioneve ne territorin e Bashkise. Hartimi dhe vendosja e planit ne objekt.
- Mledhja e te dhenave per te gjithe personat, institucionet, ojf etj. qe kane rol ne planizimin dhe menaxhimin e EC.
- Hartimiiskemes se lajmerimit.
- Vleresim i rrezikut qe egziston, prekshmerise dhe aftesive reaguese qe disponojme ne territorin e Bashkise Shkoder.
- Pajisja me plane masat per te gjithe territorin ne rast rreziku.
- Hartimi i dokumentit: Plani i menaxhimit të EC për të gjitha NJA dhe Bashkinë Shkodër.

Dokumentimi i të dhënave për fermat bujqësore dhe bizneset që ndihmojnë në planizimin dhe menaxhimin e EC.

**ii. Synimi i projektit**

Gjate viteve zonatendryshmeteShkodrës ,janendeshurkryesishtngapermbytjet e lumenjve dhe fatkeqesi te tjera te shkaktuara nga veprimtaria njerezore.
Duke ju referohuar

- shkresës së Ministrisë së Brendshme nr. 7007 date 20.10.2016 " Per planifikimin e fondeve për mbrojtjencivilédhe per hartimin e dokumentacionit per familjet ,banesat e te cileve jane demtuar nga fatkeqesi te ndryshme ,
- Ligjit nr. 8756 date 26.03.2001 "Për emergjencat Cicile"I perditësuar ,
- VKM 329 datë 16.05.2016 "Per kriteret dhe procedurat e dhenies se ndihmes shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerzore"

kemi parashikuar dhënien e shpërblimeve për familje të dëmtuara.
Në këtë fazë ne synojmë:

- Shërbim i qëndrueshëm për mbrotjen civile në cdo pjesë të territorit të Bashkisë Shkodër.
- Ngritja e strukturës së vullnetarëve civilë si pjesë e rëndësishme e strukturave të mbrojtjes civile.
- Përmirësimi i sigurisë publike në të gjithë territorin e Bashkisë Shkodër, duke siguruar informacion publik të vazhdueshëm për reziqet dhe aktivitetet e Bashkisë, me prioritet parandalimin e situtave që cenojnë sigurinë e jetës dhe pronës së qytetarëve,bizneseve, aseteve administrative, pasurive kulturore, natyrore, etj.

**iii. Aktivitetet kryesore të projektit**

1. Ndërtimi i database për inventaret e burimeve njerzore dhe mjeteve nga çdo zyrë e institucion varësie të Bashkisë dhe institucioneve të tjera në territorin e Bashkisë.
2. Reabilitimi i nje zyre ku do të sistemohet personel idrejtorise
3. Kontrollimi i gjendjes dhe funksionimit të mjeteve teknike të mjetëve në dispozicion. Vleresimi i disponibilitetit të burimeve njerzore për përfshirjen e tyre në planizimin dhe menaxhimin e EC.
4. Mbledhja e te dhenave nga të gjitha kompanitë private për mjetet që perdoren nga ana e tyre dhe që mund të angazhohen në rast te EC.
5. Trajnimi stafit
6. Dokumentimi i planimetrisë së cdo objekti në territor. Hartimi për ato që nuk kane planimetri.
7. Mledhja e të dhënave për të gjithë personat, institucionet, ojf etj. që kanë rol në planizimin dhe menaxhimin e EC.
8. Hartimiiskemëssëlajmërimit.
9. Grumbullimi i të gjithe dokumentacionit egzistues për vlerësimin e riskut në territor.
10. Përgatitja e hartave të rrezikut për territoret që mungojnë.
11. Vleresimi i prekshmerisë nga rreziku që ekziston në territor.
12. Vlerësimiiaftësivereaguesendajemergjencës.
13. Takime në çdo NJA, rajon, lagje me perfaqësues komuniteti e struktura për hartimin e planit të masave që merren në rast rreziku.
14. Mledhja e të dhenave nga DBUMK Shkodër, nga NJA për fermat.
15. Mledhja e të dhenave nga Drejtoria e të ardhurave për bizneset.

**b) Rezultatet që prisni**

- Bashkia Shkodër përballon në mënyrenmë optimale situatat e emergjencave civile ( ka kontroll mbi territorin, ka plan emergjence masash)

| **c) Aktorët e mundshëm** | **d) Kontributet e mundshme në projekt** |
|---|---|
| Stafi i MZSH, Bashkia Shkodër, DPEC, Drejtoria e Burimeve Njerzore dhe e Shërbimeve mbështetëse | Bashkia Shkodër |

e) Shpenzimet e llogaritura ( për çdo aktivitet të mësipërm (pika iii)

| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2017** | | Totali (mijë lekë) | Nga kjo: | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Transferime | kapitale |
| A.1 | Shpërblim për familjet e dëmtuara nga fatkeqesitë natyrore etj | 1 500 | | | | 1 500 | |
| | **Shuma** | **1 500** | | | | **1500** | |
| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2018** | | Totali (mijë lekë) | Nga kjo: | | | | |
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Transferime | kapitale |
| A.1 | Shpërblim për familjet e dëmtuara nga fatkeqesitë natyrore etj | 1 500 | | | | 1 500 | |
| | **Shuma** | **1 500** | | | | **1500** | |
| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2019** | | Totali (mijë lekë) | Nga kjo: | | | | |
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Transferime | kapitale |
| A.1 | Shpërblim për familjet e dëmtuara nga fatkeqesitë natyrore etj | 1 500 | | | | 1 500 | |
| | **Shuma** | **1 500** | | | | **1500** | |

| **f) Periudha e zbatimit** | **g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:** |
|---|---|
| janar 2017- dhjetor 2017 | ZVEC |

| Nr. 2 | **Projekti : P13.F2.O1.A1**<br><br>Shërbimi i MZSH | **Llojet e programit: P13**Planifikim, Manaxhim, Administrim<br><br>**Funksioni : P13.F2** Garantimin e shërbimit të zjarrfikësve në nivel lokal dhe administrimi i strukturave përkatëse, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj; |
|---|---|---|

**a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:**

**i. Situata**

Në ligjin Nr. 139/2015 "PËR VETËQEVERISJEN VENDORE", Neni 29, "Funksionet e bashkive në fushën e sigurisë publike", pika 2, parashikon "*Garantimin e shërbimit të zjarrfikësve, në nivel vendor, dhe administrimin e strukturave përkatëse, sipas mënyrës së* përcaktuar me ligj" sipas këtij ligji, ky funksion i kaloi Bashkisë së Shkodrës
Për realizimin e këtij shërbimi përvec strukturës së brendshme të Bashkisë së Shkodrës, që ndjek politikat vendore për këtë veprimtari, do të funksionojë edhe Institucioni i varësisë "Drejtoria e emergjencave civile, mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit, krijuar me Urdhër të kryetarit të Bashkisë Shkodër, nr.13, datë 19.01. 2016.
Transferta specifike e parashikuar në Ligjin për Buxhetin e Shtetit të vitit 2017,(rreshti nr.1) parashikohet në buxhetin e bashkisë për t'u shpenzuar për këtë funksion (paga, sigurime dhe shpenzime operative ) mpër shërbimin e "Drejtoria e emergjencave civile, mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit" parashikon shpenzimet per paga, sigurime shoqërore dhe shpenzime operative.
Shërbimi i mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, në vijim shërbimi i MNZSH-së, është strukturë e specializuar e gatishmërisë së përhershme. Misioni i këtij shërbimi është inspektimi, parandalimi, me masat e mbrojtjes nga zjarri, ndërhyrja për shuarjen e zjarreve, shpëtimi i jetës, gjësë së gjallë, pronës, mjedisit, pyjeve dhe kullotave në aksidente të ndryshme, fatkeqësi natyrore, si dhe në ato të shkaktuara nga dora e njeriut (LIGJ Nr. 152/2015 Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, neni 2)
Po sipas këtij ligji,
**në Nenin 7**, Organizimi i strukturës së shërbimit, pikat 3. Drejtoria ose sektori i shërbimit të MZSHsë në nivel vendor është në varësi të kryetarit të bashkisë. Ajo përfaqëson strukturën bazë operuese dhe inspektuese në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin në territorin që ka në juridiksion.
4. Çdo bashki duhet të mbulojë territorin e saj me shërbim zjarrfikës, me stacione të kompletuara me personel, automjete dhe pajisje zjarrfikëse
**Në Nenin 9**, Kryetari i bashkisë ka këto përgjegjësi:
a) merr masa për ngritjen dhe kompletimin me mjete e pajisje të stacioneve për fikjen e zjarreve dhe shpëtimin, të shërbimit të MZSH-së në territorin e bashkisë, sipas standardeve e normave në fuqi;
b) planifikon fondet e shërbimit të MZSH-së, nga buxheti i bashkisë, për çdo vit(rreshti nr.2)
Ne llogarine Transferime korente do te trajtohen disa punonjes, të cilët në zbatim të VKM 499 date 13.08.1998i ndryshuar me VKM 633 date 28.10.1998,përfitojne shperblim per perballimin e ngarkeses familjare mbi 3 femije.

**ii. Synimi i projektit**

Forcimi i Institucionit të MZSH
Shërbim më i mirë dhe eficient i MZSH si rezultat i rritjes së stafit dhe organizimit më të mirë të ndarjes së funksioneve.
Trainime të stafit
Shërbim më i mirë dhe eficient i MZSH si rezultat i rritjes së vazhdueshme të stafit dhe organizimit më të mirë të ndarjes së funksioneve.

**iii. Aktivitetet kryesore të projektit**

1. Transferta specifike në Ligjin për Buxhetin e Shtetit të vitit 2016, parashikohet në buxhetin e bashkisë për t'u shpenzuar për këtë funksion (paga, sigurime dhe shpenzime operative ).
2. Procedura përgatitore
   - Hartimi i kalendarëve të gadishmërisë dhe grupeve
   - Hartimi i procedurave për kryerjen e shpenzimeve
3. Raportet e gadishmërisë dhe të ndërhyrjeve në rastet e emergjencave

**b) Rezultatet që prisni**

- Rritja e sigurisë së jetës dhe të pronës së qytetarëve
- Minimizimi i dëmeve që mund të shkatohen nga zjarri apo emergjencat e tjera
- Funksionimimirëi strukturës
- Kryerjesipaskërkesaveishërbimit

| c) Aktorët e mundshëm | d) Kontributet e mundshme në projekt |
|---|---|
| Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse | Bashkia Shkodër |

**e) Shpenzimet e llogaritura**

| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2017** | Totali ( mijë lekë) | Nga kjo: | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Paga | Sigurime | Operative | Transferime | kapitale |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| A.1 | Paga | 26 467 | 26 467 | | | | |
| A.2 | Sigurime | 4 257 | | 4 257 | | | |
| A.3 | Kompensime | 360 | | | | 360 | |
| A.4 | Kancelari | 50 | | | 50 | | |
| A.5 | Materiale për pastrim,dizifek.,ngrohje dhe ndriçim | 50 | | | 50 | | |
| A.6 | Blerje dokumentacion | 10 | | | 10 | | |
| A.7 | Karburanti | 1600 | | | 1600 | | |
| A.8 | Pjesë këmbimi, goma dhe bateri | 120 | | | 120 | | |
| A.9 | Rregjistrim,kalaudim , | 250 | | | 250 | | |
| A.11 | Siguracionautomjetesh | 180 | | | 180 | | |
| A.12 | Shpenzimeudhëtimitëbrndëshme | 40 | | | 40 | | |
| A.14 | Pagesëenergjielektrike | 300 | | | 300 | | |
| A.15 | Pagesëujësjellsi | 100 | | | 100 | | |
| A.16 | Pagesëshërbimetelefonike | 120 | | | 120 | | |
| A.17 | Pagesëshërbimeprintimidhepublikim e | 60 | | | 60 | | |
| A.18 | TrajnimedheSeminare | 200 | | | 200 | | |
| A.19 | Shpenzimepërmirmbajtjetëzakonsh memjetetransporti | 200 | | | 200 | | |
| A.20 | Shpenzimepërmirëmbajtjepaisjezyre etj | 50 | | | 50 | | |
| A.21 | Uniforma per punonjesit e MZSH (35Komplete) | 1200 | | | **1 200** | | |
| | **Shuma** | **35 574** | 26 427 | 4 257 | **4 530** | **360** | |
| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2018** | | Totali (mijë lekë) | Nga kjo: | | | | |
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Transferime | kapitale |
| A.1 | Paga | 26 996 | 26 996 | | | | |
| A.2 | Sigurime | 4 301 | | 4 301 | | | |
| A.3 | Kompensime | 360 | | | | 360 | |
| A.4 | Shpenyime operative | 3100 | | | 3100 | | |
| | **Shuma** | **34757** | 26 996 | 4 301 | **3100** | **360** | |
| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2019** | | Totali (mijë lekë) | Nga kjo: | | | | |
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Transferime | kapitale |
| A.1 | Paga | 27 536 | 27 536 | | | | |
| A.2 | Sigurime | 4 387 | | 4 387 | | | |
| A.3 | Kompensime | 450 | | | | 450 | |
| A.4 | Shpenzime operative | 3100 | | | 3100 | | |
| | **Shuma** | **35 473** | | | **3100** | **450** | |

| | |
|---|---|
| **f) Periudha e zbatimit (kurfillon, kurpërfundon)**<br>janar – dhjetor 2016 | **g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:**<br>MZSH |

| | | |
|---|---|---|
| Nr. 3 | **Projekti : P13.F2.O1.A2**<br>Plotësimi i dokumentacionit ligjor teknik përmasat MZSH dhe çertefikimi për MZSH i tëgjitha objekteve të vartësi të Bashkisë. | **Llojet e programit: P13** Planifikim, Manaxhim, Administrim<br><br>**Funksioni: P13.F2** Garantimin e shërbimit të zjarrfikësve në nivel lokal dhe administrimi i strukturave përkatëse, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj; |

**a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:**

**i. Situata**

Nëligjin Nr. 139/2015 "PËR VETËQEVERISJEN VENDORE", Neni 29, "Funksionet e bashkive në fushën e sigurisë publike" parashikohet:

1. Mbrojtjen civile, në nivel vendor, dhe administrimin e strukturave përkatëse, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.
2. Garantimin e shërbimit të zjarrfikësve, në nivel vendor, dhe administrimin e strukturave përkatëse, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.

Pjesa më e madhe e objekteve që përdoren nga Bashkia Shkodër për realizimin e funksioneve të saj nuk janë të pajisura më aktet për MZSH.
Objektet nuk kanë mjetet e nevojshme dhe të detyrueshme sipas ligjit per MKZ.
Kjo situatë dëmton rëndë sigurinë në këto objekte dhe kryesisht atë të jetës së qytetarëve.
Sipas Ligjit 152/2015 "Për shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin" neni 3 germa 2 tek perkufizimet " Çertifikat e mbrojtjes nga zjarri" është akti administrativ , i lëshuar nga shërbimi i MZSH-së , nëpërmjet të cilit provohet përmbushja e kërkesave të parashikuara në projektin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin , sipas kategorizimit të objekteve.
Sipas kreut IX neni39 pika 1, 2, 3, 4 parashikojne se çdo objekt duhet të ketë projektin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin.
Urdhëri i Ministrit 425 dt.24.07.2015 "Për pranimin,administrimin e dokumentacionit teknik dhe grafik të projekteve të mbrojtjes nga zjarri dhe për shpetimin dhe lëshimin e akteve teknike (çertifikatave të zjarrit) normon dokumentacionin që duhet paraqitur për plotësimin me çertifikatë zjarri.
VKM 285 dt 27.06.2002 pika 3.1 dhe 3.2 caktojne tarifat per çertifikata zjarri dhe perseritjen e tyre vit pas viti,
Prandaj na lind detyrimi te plotësojmë dokumentacionin ligjor teknik për MZSH dhe certefikimi për MZSH për i të gjitha objekteve të vartësi të Bashkisë dhe te godinën e Bashkisë (veçanërisht).
Ky shërbim do të prokurohet ne bazë të ligjit të prokurimit.
Gjatë vitit 2016 është realizuar paisja me bombola fikse zjarri 100 shkolla Bashkisë Shkodër, nderkohë që në vazhdim parashikojmë te plotesojmë instutucionet e tjera të papaisura me fikse zjarri.

**ii. Synimi i projektit**

2017
Plotësimi i dokumentacionit ligjor teknik për MZSH dhe certefikimi për MZSH për godinën e Bashkisë (veçanërisht).
Plotësimi i dokumentacionit ligjor teknik për masat MZSH dhe certefikimi për MZSH i të gjitha objekteve të vartësi të Bashkisë.
Rimbushja e bombulave të fikseve automatike të zjarrit.

2018
Kryerja e kontrollit sistematik vjetor dhe certefikimi për MZSH i objektevetëBashkisë.
Blerja e fiksevë automatikepërobjektetetjera.
Rimbushja e bombulavetëfikseveautomatiketëzjarrit.
Rifreskimi i akteve teknike për MZSH.
2019
Kryerja e kontrollitsistematikvjetordhecertefikimipër MZSH i objektevetëBashkisë.
Blerja e fiksevëautomatikepërobjektetetjera.
Rimbushja e bombulavetëfikseveautomatiketëzjarrit.
Rifreskimi i akteve teknike për MZSH.

**iii. Aktivitetet kryesore të projektit**

1. Kontrolli dhe pajisja e të gjitha objekteve me çertefikatën për MKZ.
2. Prokurimi i të gjitha mjeteve MKZ per te gjitha objektet në admnistrim të Bashkisë.

**b) Rezultatet që prisni**

1. Rritje e sigurisë publike në objektet ku realizon kompetencat Bashkia Shkodër.(Objekte të kolauduara për MKZ. Objekte të pajisura me grupin e mjeteve për MKZ).

| c) Aktorët e mundshëm | d) Kontributet e mundshmenëprojekt |
|---|---|
| Personeli i ZVEC<br>Zyrat e tjera të bashkisë | Bashkia Shkodër |

**e) Shpenzimet e llogaritura**

| Shpenzimet për çdo aktivitet 2017 | | Totali (mijë lekë) | Nga kjo: | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Transferime | kapitale |
| A.1 | Projektimi akteve teknike kundra zjarrit | 3000 | | | | | **3 000** |
| A.2 | Blerje dhe Rimbushtje fikse Zjarri | 2 500 | | | 2 500 | | |
| A.3 | Blerje Sensor tymi | 1 500 | | | 1 500 | | |
| | **Shuma** | **7 000** | | | **4 000** | | **3 000** |
| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2018** | | Totali (mijë lekë) | Nga kjo: | | | | |
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Transferime | kapitale |
| A.1 | Rifreskim akteve teknike për MZSH | | | | | | |
| A.2 | Rimbushtje fikse Zjarri | 3500 | | | 3500 | | |
| | **Shuma** | **3 500** | | | **3 500** | | |
| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2019** | | Totali (mijë lekë) | Nga kjo: | | | | |
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Transferime | kapitale |
| A.1 | Rifreskim akteve teknike për MZSH | | | | | | |
| A.2 | Rimbushtje fikse Zjarri | 3500 | | | 3500 | | |
| | **Shuma** | **3 500** | | | **3 500** | | |
| **f) Periudha e zbatimit** janar – dhjetor 2016 | | | **g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:** ZVEC MZSH | | | | |